

VENDIM
Nr. 455, datë 10.7.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË BLOKUT NR. 3, NË QENDËR TË QYTETIT TË ROSKOVECIT (FAZA 1)”, BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (faza 1)”, Bashkia Roskovec.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Roskovec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 431 003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 431 003 (nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e një mijë e tre) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Roskovec.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruara në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Roskovec.

8. Bashkia Roskovec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Roskovec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Roskovec për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Roskovec, për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Roskovec, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË BLOKUT NR. 3, NË QENDËR TË QYTETIT ROSKOVEC (FAZA 1)”, BASHKIA ROSKOVEC

Nr. rendor	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE SIPAS KARTELËS SË PASURISË										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM							SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m ²)	Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	Volumi	Faqe	ARË			TRUALL			VLERA TOTALE (lek)	
														Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)		
1	Eqerem Et'hem Hajrie Ilirjan Jolldiz Kujtim Mehdiye Muharrem Pranvera Rubie Senije Umberto Xheladin Ymid		Risilia Resuli Shehu Kongoli Bedini Kryeziu Hoxha Resuli Kryeziu Risilia Resuli Resuli Kryeziu Resuli	Roskovec	3196	2/282	Truall	6900	0	6900	0	14	74				6900	494	3,408,600	3,408,600	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Eqerem Et'hem Hajrie Ilirjan Jolldiz Kujtim Mehdiye Muharrem Pranvera Rubie Senije Umberto Xheladin Ymid		Risilia Resuli Shehu Kongoli Bedini Kryeziu Hoxha Resuli Kryeziu Risilia Resuli Resuli Kryeziu Resuli	Roskovec	3196	2/283	Truall	9775	0	9755	0	14	75	0	269	-	9775	494	4,828,850	4,828,850	Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni D i kartelës së pasurisë: - Referenca nr. 2342, datë 22.7.2017: Me vendimin datë 31.5.2010 të Gjykatës Fier bëhet regjistrimi i padisë nr. 1230 prot., datë 19.5.2010.
3	Servet	Dervish	Pirra	Roskovec	3196	352/13	arë	3687	3687	0	0	16	123	2675	269	719,575	0	494	0	719,575	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Gezim	Servet	Pirra	Roskovec	3196	352/18	arë	2000	2000	0	0	16	121	1286	269	345,934	0	494	0	345,934	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Fredi Zana Rudina Resmije Edlira Mira Xhuljeta	Asqeri Elmas Asqeri Asqeri Asqeri	Dyle Dyle Mullaj Rrapushaj Haxhij Xhaxhaj Dyle	Roskovec	3196	349/10	arë	6600	6600	0	0	23	121	476	269	128044	0	494	0	128,044	Konfirmuar nga ASHK-ja Seksioni D i kartelës së pasurisë: - Referenca nr. 2817, datë 30.12.2013: Mbi këtë pasuri ka një ndërtim të paligjshëm.
VLERA TOTALE																1,193,553			8,237,450	9,431,003	